


KËRKESE PËR INFORMACION

Emër Mbiemër¹: Z./Znj. Jona Plumbi	Adresa postare: Rruga “Nasi Pavlo”, Pallati “Edil-al”, shk 1, kati 3, ap 8 Adresa elektronike: jona@faktoje.al Nr. Tel: 0692680234	Data: 5/03/2024 Nënshkrimi: 
---	---	---

Autoriteti Publik : Ministria e ekonomisë kulturës dhe inovacionit
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr.4, Tirane, Shqiperi
Qyteti: Tiranë

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Nisur nga dy marrëveshje të firmosura në vitin 2021 mes antareve të nismës Open Balkan, në janar 2024 Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia firmosën dy protokolle për zbatimin e marrëveshjeve për tregun e lirë të punës dhe për identifikimin elektronik të qytetarëve në vendet respektive. Nisur nga kjo, lutemi të na informoni për sa më poshtë:

1. Protokollin e firmosur mes Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut për tregun e lirë të punës, përmes cilës procedure të brendshme ligjore do të miratohet për tu vendë në zbatim?
2. A do duhet të votohet protokollin e firmosur në 22 shkurt 2024 në Kuvendin e Shqipërisë që me pas të implementohet?
3. Në çfarë faze është përgatitja e faqes online për aplikimin e qytetarëve për akses të lirë në tregun e punës?

Lidhur me këtë kërkesë, bazuar në informacionin që ne disponojmë, ju bëjmë me dije se:

Marrëveshja për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor u miratua me VKM nr.70, datë 2.2.2022 “Për miratimin e marrëveshjes për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor” dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr.18, datë 04.02.2022;

¹ Në rastet kur informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale, kërkohet dokumenti i identifikimit të kërkuarit.

Kjo Marrëveshje synon të sigurojë që shtetasit e Palëve Kontraktuese të saj, të kenë të drejtën të lëvizin, qëndrojnë dhe punojnë lirisht brenda territorit të Palëve Kontraktuese, në përputhje me përcaktimet në këtë marrëveshje.

Për të ushtruar të drejtën e aksesit të lirë në tregun e punës, një shtetas i një Pale Kontraktuese do të regjistrojë të dhëna personale dhe të dhëna të tjera, siç kërkohet nga shërbimi i duhur elektronik *online* i zhvilluar nga secila Palë Kontraktuese në përputhje me legjislacionin vendas dhe *Marrëveshjen për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor* (neni 7, paragrafi 1 i Marrëveshjes).

Sipas nenit 7, paragrafi 3 të kësaj marrëveshje, një shtetas i një Pale Kontraktuese, *që disponon një numër ID-je të Ballkanit të Hapur*, do të konsiderohet se është regjistruar për akses të lirë në tregun e punës në territorin e Palës Marrëse, pasi të jetë njoftuar në mënyrë elektronike, se procedura e aplikimit ka përfunduar dhe se aksesit i lirë në tregun e punës është miratuar, i cili i jep të drejtën e aksesit të lirë në tregun e punës.

Zbatimi i Marrëveshjes për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor është i lidhur ngushtësisht jo vetëm me hyrjen në fuqi, por dhe zbatimin e Marrëveshjes për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor (neni 19 i Marrëveshjes për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor).

Marrëveshja për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor, u miratua me VKM nr.69, datë 2.2.2022 “*Për miratimin e marrëveshjes për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor*” dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr.18, datë 04/02/2022.

Qëllimi i marrëveshjes për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor (BP) është që palët kontraktuese të ofrojnë akses në shërbimet e tyre të *e-geverisjes*, për shtetasit e Palëve të tjera Kontraktuese, duke përdorur skemat e verifikimit për identifikimin elektronik të Palës Kontraktuese, së cilës i përket shtetasi që përdor shërbimet e qeverisjes elektronike, *e-qeverisje*.(neni 1 i marrëveshjes).

Të dyja marrëveshjet e sipërpermendura parashikojnë hartimin dhe lidhjen e protokolleve që do mundësojnë zbatimin e plotë të tyre (neni 16, Marrëveshjes për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në BP, neni 8 Marrëveshja për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të BP).

Neni 16 i Marrëveshjes për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor, përcakton se, palët kontraktuese bien dakord që protokollet shitesë mund të rregullojnë më tej çështjet që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, veçanërisht çështjet që lidhen me sistemin e informacionit që mundëson regjistrimin, si dhe çështjet që lidhen me qëndrimin, lëvizjen dhe punën e shtetasve në territorin e Palës Marrëse.

Ndërsa neni 8 i marrëveshjes për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor, përcakton se: “*Përshkrimi teknik i numrit të ID-së për Ballkanin e Hapur dhe proceset e tij, do të përcaktohen në Protokollet shitesë të kësaj Marrëveshjeje*”.Në

mënyrë të vecantë neni 8 i marrëveshjes ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor që kërkon miratimin e protokollit shtesë për ID për Ballkanin e Hapur, është një element bazë për zbatimin e marrëveshjes për kushtet për akses të lirë në tregun e punës, pasi sipas nenit 7 të kësaj marrëveshje shtetasi i palës kontraktuese duhet të disponojë një numër ID të Ballkanit të Hapur.

Marrëveshja është miratuar në parim me VKM nr.384, datë 1.6.2022, “Për miratimin, në parim, të Protokollit të parë për zbatimin e marrëveshjes për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor”, dhe është firmosur në 22 Janar 2024 nga përfaqësuesit e Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Serbisë.

Protokolli pritet t’i nënshtrohet miratimit përfundimtar nga Këshilli i Ministrave dhe të hyjë në fuqi në përputhje me nenin 11 të Protokollit.

Për më shumë informacion lidhur me hartimin dhe procedurat e ndjekura për miratimin e Protokolleve Shtesë nga Palët Kontraktuese në zbatim të nenit 16 të marrëveshjes kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor dhe nenit 8 të marrëveshjes për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin, kapacitetet dhe sistemet e regjistrimit dhe e-qeverisjes, sugjerojmë të drejtoheni pranë Ministrisë së Brendshme, si autoriteti kryesor që ka koordinuar procesin e hartimit dhe të miratimit të dy protokolleve të sipërpërmendura, si dhe pranë Drejtorisë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, Policia e Shtetit Shqiptar dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Faleminderit

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: postë elektronike

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.